**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**
***Qeveria – Vlada – Government***

---

# PROJEKTLIGJI PËR INSPEKTORATIN QENDROR TË TRASHËGIMISË KULTURORE[1]

# DRAFT LAW ON CENTRAL INSPECTORATE OF CULTURAL HERITAGE[2]

# NACRT ZAKONA O CENTRALNOM INSPEKTORATU KULTURNOG NASLEĐA[3]

[1] Projektligji për Inspektoratin Qendror të Trashëgimisë Kulturore, është aprovuar në mbledhjen e 11-të, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me Vendimin nr.10/11, të dates, 20.04.2026.
[2] Draft Law on Central Inspectorate of Cultural Heritage, haas been in the 11, metting of the Government of the Republic of Kosovo, with the Decision, No.10/11, dated 20.04.2026.
[3] Nacrt Zakona o Centralnom Inspektoratu Kulturnog Nasleđa, usvojeno na 11, Sednici Vlade, sa Odlukom Br.10/11, datum 20.04.2026

| | | |
|---|---|---|
| **Kuvendi i Republikës së Kosovës,** | **Assembly of the Republic of Kosovo,** | **Skupština Republike Kosovo,** |
| Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, | Pursuant to Article 65 (1) of the Constitution of the Republic of Kosovo, | Na osnovu člana 65 (1) Ustava Republike Kosova, |
| Miraton: | Adopts: | Usvaja: |
| **LIGJ PËR INSPEKTORATIN QENDROR TË TRASHËGIMISË KULTURORE** | **LAW ON CENTRAL INSPECTORATE OF CULTURAL HERITAGE** | **ZAKON O CENTRALNOM INSPEKTORATU KULTURNOG NASLEĐA** |
| **KAPITULLI I<br>DISPOZITAT E PËRGJITHSHME** | **CHAPTER I<br>GENERAL PROVISIONS** | **POGLAVLJE I<br>OPŠTE ODREDBE** |
| **Neni 1<br>Qëllimi** | **Article 1<br>Purpose** | **Član 1<br>Svrha** |
| Ky ligj ka për qëllim themelimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Qendror të Trashëgimisë Kulturore. | The purpose of this law is the establishment, organization, and functioning of the Central Inspectorate of Cultural Heritage. | Ovaj zakon ima za cilj osnivanje, organizovanje i funkcionisanje Centralnog inspektorata o kulturnom nasleđu. |
| **Neni 2<br>Fushëveprimi** | **Article 2<br>Scope** | **Član 2<br>Delokrug** |
| Dispozitat e këtij ligji zbatohen për inspektimet në fushën e trashëgimisë | The provisions of this law shall apply to inspections in the field of cultural heritage | Odredbe ovog zakona primenjuju se na inspekcijske poslove primenjuju se na |

| | | |
|---|---|---|
| kulturore ndaj personave që kanë të drejta dhe obligime ndaj aseteve të trashëgimisë kulturore, në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi. | for persons who have rights and obligations regarding cultural heritage assets in accordance with the relevant legislation in force. | inspekcije u oblasti kulturnog nasleđa nad licima koja imaju prava i obaveze na dobrima kulturnog nasleđa, u skladu sa važećim zakonima. |
| **Neni 3**<br>**Përkufizimet** | **Article 3**<br>**Definitions** | **Član 3**<br>**Definicije** |
| 1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime: | 1. The expressions used in this law have the following meaning: | 1. Izrazi korišćeni u ovoj uredbi imaju sledeće značenje: |
| 1.1. **Ministria** - nënkupton Ministrinë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore; | 1.1. **Ministry** - means the Ministry responsible for cultural heritage; | 1.1. **Ministarstvo** - označava Ministarstvo nadležno za kulturno nasleđe; |
| 1.2. **Ministri -** nënkupton ministrin përgjegjës për trashëgiminë kulturore; | 1.2. **Minister -** means the minister responsible for cultural heritage; | 1.2. **Ministar -** označava ministra nadležnog za kulturno nasleđe; |
| 1.3. **IQTK -** nënkupton Inspektoratin Qendror të Trashëgimisë Kulturore; | 1.3. **CICH -** means the Central Inspectorate of Cultural Heritage; | 1.3. **CIKN -** označava Centralni inspektorat o kulturnom nasleđu; |
| 1.4. **Person -** nënkupton personin fizik, juridik, vendës apo të huaj, që i nënshtrohet inspektimit sipas legjislacionit në fuqi. | 1.4. **Person -** means a natural or legal person, local or foreign, subject to inspection according to the legislation in force. | 1.4. **Osoba -** označava fizičko, pravno, domaće ili strano lice, koje podleže inspekciji u skladu sa zakonima na snazi. |
| 2. Të gjitha shprehjet e tjera të përdorura në këtë ligj kanë kuptimin e njëjtë si në ligjin përkatës për inspektimet dhe në legjislacionin relevant në fuqi. | 2. All other expressions used in this law shall have the same meaning as in the corresponding law on inspections and in the relevant legislation in force. | 2. Svi ostali izrazi koji se koriste u ovom zakonu imaju isto značenje kao u relevantnom zakonu o inspekcijama i u relevantnom zakonu na snazi. |

| | | |
|---|---|---|
| **Neni 4**<br>**Statusi dhe organizimi i Inspektoratit Qendror të Trashëgimisë Kulturore**<br><br>1. IQTK-ja themelohet si agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Kulturës dhe Turizmit.<br><br>2. IQTK-ja ushtron juridiksionin në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe organizohet në nivel qendror dhe në degë lokale.<br><br>3. Në pajtim me paragrafin 2 të këtij neni, degët lokale të IQTK-së mund të përfshijnë territorin e një ose më shumë komunave.<br><br>4. IQTK-ja e ka selinë në Prishtinë.<br><br>**Neni 5**<br>**Funksionet dhe përgjegjësitë e IQTK-së**<br><br>1. IQTK-ja është përgjegjëse për kontrollin dhe vlerësimin e kushteve dhe të gjendjes së ruajtjes së trashëgimisë kulturore dhe sipas nevojës ndërmerr masat e duhura për ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. | **Article 4**<br>**Status and organization of the Central Inspectorate of Cultural Heritage**<br><br>1. CICH is established as an executive agency within the Ministry of Culture and Tourism/<br><br>2. CICH exercises jurisdiction over the entire territory of the Republic of Kosovo and is organized at the central level and in local branches.<br><br>3. In accordance with paragraph 2 of this article, the local branches of the CICH may cover the territory of one or more municipalities.<br><br>4. CICH is headquartered in Prishtina.<br><br>**Article 5**<br>**Functions and responsibilities of CICH**<br><br>1. CICH is responsible for monitoring and evaluating the conditions and state of preservation of cultural heritage, and, when necessary, taking appropriate measures to preserve and protect cultural heritage. | **Član 4**<br>**Status i organiziranje Centralnog inspektorata o kulturnom nasleđu**<br><br>1. CIKN se obrazuje kao izvršna agencija u okviru Ministarstvo Kulture i Turizma<br><br>2. CIKN ima jurisdikciju na celoj teritoriji Republike Kosovo i organizovan je na centralnom nivou i u lokalnim ograncima.<br><br>3. U skladu sa stavom 2. ovog člana, mesne filijale CIKN-a mogu obuhvatati teritoriju jedne ili više opština.<br><br>4. Sedište CIKN-a je u Prištini .<br><br>**Član 5**<br>**Funkcije i odgovornosti CIKN-a**<br><br>1.CIKN je odgovoran za kontrolu i procenu uslova i stanja očuvanosti kulturnog nasleđa i po potrebi preduzima odgovarajuće mere za očuvanje i zaštitu kulturnog nasleđa. |

| | | |
|---|---|---|
| 2. IQTK-ja ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në pajtim me metodologjinë e inspektimit të bazuar në rrezik, në veçanti, si dhe ligjin përkatës për inspektimet dhe ligjin përkatës për trashëgiminë kulturore, në përgjithësi. | 2. CICH exercises its functions and responsibilities in accordance with a risk-based inspection methodology, in particular, as well as the relevant law on inspections and the relevant law on cultural heritage, in general. | 2.CIKN vrši funkcije i odgovornosti u skladu sa metodologijom inspekcije zasnovanom na riziku, posebno, kao i relevantnim zakonom o inspekciji i relevantnim zakonom o kulturnom nasleđu, uopšte. |
| 3. Në pajtim me paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, IQTK-ja ushtron funksionet dhe përgjegjësitë si në vijim: | 3. In accordance with paragraphs 1 and 2 of this article, CICH exercises the following functions and responsibilities: | 3.U skladu sa st. 1. i 2. ovog člana, CIKN vrši sledeće funkcije i odgovornosti:: |
| 3.1. vlerëson dhe kontrollon zbatimin e legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore; | 3.1. evaluates and monitors the implementation of current legislation on cultural heritage; | 3.1. ocenjuje i kontroliše primenu važeće zakonske regulative o kulturnom nasleđu; |
| 3.2. inspekton në mënyrë të pavarur asetet e trashëgimisë kulturore dhe bën vlerësimin e kushteve dhe të gjendjes së ruajtjes së trashëgimisë kulturore, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi; | 3.2. independently inspects cultural heritage assets and evaluates the conditions and state of preservation of cultural heritage, in accordance with the relevant legislation in force; | 3.2. samostalno vrši inspekciju dobara kulturnog nasleđa i ocenjuje uslove i stanje očuvanosti kulturnog nasleđa, u skladu sa relevantnim zakonima na snazi |
| 3.3. urdhëron ndalimin e menjëhershëm të çdolloj pune të paautorizuar në asetet e trashëgimisë kulturore; | 3.3. orders the immediate cessation of any unauthorized work on cultural heritage assets; | .3. nalaže hitno obustavljanje svakog neovlašćenog rada na dobrima kulturnog nasleđa; |
| 3.4. urdhëron ndalimin e punëve konservuese dhe restauruese në rast të identifikimit të parregullsive gjatë zbatimit të tyre dhe derisa kushtet e nevojshme të plotësohen për përmbylljen e punëve të tilla; | 3.4. orders the cessation of conservation and restoration works if irregularities are identified during their implementation, until necessary conditions are met for the completion of such works; | 3.4. nalaže zabranu konzervatorsko-restauratorskih radova u slučaju utvrđivanja nepravilnosti tokom njihovog izvođenja i dok se ne steknu neophodni uslovi za završetak takvih radova; |

| | | |
|---|---|---|
| 3.5. ndërmerr veprime konkrete ndaj personave në rastet e punimeve të paautorizuara me të cilat dëmtohen asetet e trashëgimisë kulturore dhe kujdeset që, përmes veprimeve të përcaktuara me ligjet në fuqi, të njëjtat të kthehen në gjendjen e mëparshme; | 3.5. Takes concrete actions against persons in cases of unauthorized works that damage cultural heritage assets and ensures that such assets are restored to their previous state through actions defined by the laws in force; | 3.5. preduzima konkretne radnje protiv lica u slučajevima neovlašćenih radova kojima se oštećuju dobra kulturnog nasleđa i stara se da se ista, kroz radnje definisane važećim zakonima, vrate u pređašnje stanje; |
| 3.6. ofron rekomandime për Ministrinë dhe institucionet e tjera të Republikës së Kosovës për ruajtjen, mbrojtjen, restaurimin dhe konservimin e trashëgimisë kulturore; | 3.6. provides recommendations to the Ministry and other institutions of the Republic of Kosovo for the preservation, protection, restoration and conservation of cultural heritage; | 3.6. daje preporuke Ministarstvu i drugim institucijama Republike Kosovo za očuvanje, zaštitu, restauraciju i konzervaciju kulturnog nasleđa; |
| 3.7. inicion procedura për kundërvajtje dhe/apo procedura penale ndaj personave që kanë dëmtuar apo shkatërruar asetet e trashëgimisë kulturore; | 3.7. initiates minor offence proceedings and/or criminal proceedings against persons who have damaged or destroyed cultural heritage assets; | 3.7. pokreće prekršajne i/ili krivične postupke protiv lica koja su oštetila ili uništila dobra kulturnog nasleđa; |
| 3.8. ndërmerr masa për parregullsi të ndryshme në raport me intervenimet si: konservim, restaurim, gërmime arkeologjike, ndryshim apo shfrytëzim ose çfarëdolloj veprimesh të tjera në fushën e trashëgimisë kulturore, si dhe rekomandon ndërmarrjen e veprimeve përkatëse sipas legjislacionit në fuqi; | 3.8. takes measures for various irregularities in relation to interventions such as: conservation, restoration, archaeological excavations, alteration or exploitation or any other actions in the field of cultural heritage, as well as recommends appropriate actions according to the legislation in force; | 3.8. preduzima mere za različite nepravilnosti u vezi sa intervencijama kao što su: konzervacija, restauracija, arheološka iskopavanja, promene ili eksploatacije ili bilo koje druge radnje u oblasti kulturnog nasleđa, kao i preporučuje preduzimanje relevantnih radnji u skladu sa važećom zakonskom regulativom; |
| 3.9. ndërmerr masa për parregullsi të ndryshme në raport me intervenimet në hapësirat e perimetrit dhe zonës | 3.9. takes measures for various irregularities in relation to interventions in the perimeter and protective zone of | 3.9. preduzima mere za različite nepravilnosti u vezi sa intervencijama u područjima perimetra i zaštitne zone |

| | | |
|---|---|---|
| mbrojtëse të aseteve të trashëgimisë kulturore si dhe rekomandon ndërmarrjen e veprimeve përkatëse sipas legjislacionit në fuqi për ruajtjen e autenticitetit dhe integritetit fizik dhe hapësinor të asetit të trashëgimisë kulturore; dhe | cultural heritage assets, as well as recommends appropriate actions according to the legislation in force to preserve the authenticity and physical and spatial integrity of the cultural heritage asset; and | dobara kulturnog nasleđa i preporučuje preduzimanje relevantnih radnji u skladu sa važećom zakonskom regulativom radi očuvanja autentičnosti i fizičkog i prostornog integriteta dobro kulturnog nasleđa; i |
| 3.10. bashkëpunon me institucionet përgjegjëse të trashëgimisë kulturore dhe inspektoratet qendrore dhe lokale të fushave të tjera përkatëse të inspektimit në kompetencë të administratës shtetërore dhe komunave në Republikën e Kosovës për adresimin dhe trajtimin e çështjeve të përbashkëta. | 3.10. cooperates with the responsible institutions of cultural heritage and the central and local inspectorates of other relevant inspection fields under the competence of the state administration and municipalities in the Republic of Kosovo in addressing and treating common issues. | 3.10. sarađuje sa nadležnim institucijama kulturnog nasleđa i centralnim i lokalnim inspektoratima drugih relevantnih oblasti inspekcije u nadležnosti državne administracije i opština u Republici Kosovo radi razmatranja i rešavanja zajedničkih pitanja. |
| 4. Procedurat për ndërmarrjen e veprimeve për zbatimin e paragrafit 3.9 të këtij neni do të rregullohen me akt nënligjor të aprovuar nga ministri. | 4. The procedures for taking actions regarding the implementation of paragraph 3.9 of this article shall be regulated by means of a sub-legal act approved by the minister. | 4. Procedure za preduzimanje radnji za primenu stava 3.9 ovog člana regulišu se podzakonskim aktom koji usvaja ministar. |
| **Neni 6**<br>**Inspektimi i akteve për zhvillime ndërtimore dhe zhvillime të tjera brenda zonave të mbrojtura të trashëgimisë kulturore** | **Article 6**<br>**Inspection of acts for construction developments and other developments within protected areas of cultural heritage** | **Član 6**<br>**Uvid u akte za građevinske radove i druge radove u okviru zaštićenih zona kulturnog nasleđa** |
| 1. IQTK-ja mund të inspektojë nxjerrjen e akteve me të cilat lejohen ndërhyrje ndërtimore dhe zhvillime të tjera brenda | 1. The CICH may inspect the issuance of acts permitting construction interventions and other developments within the | 1. CIKN može vršiti uvid u izdavanje akata koji dozvoljavaju građevinske intervencije i druge radove u okviru |

| | | |
|---|---|---|
| zonave të mbrojtura të trashëgimisë kulturore për t'u siguruar se për të njëjtat janë respektuar procedurat sipas dispozitave të ligjeve në fuqi për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.<br><br>2. Nëse konstatohet se leja, si në paragrafin 1 të këtij neni, është lëshuar në mospërputhje me dispozitat ligjore në fuqi IQTK-ja nxjerr vendim me të cilin e obligon nëpunësin e organit kompetent të pezullojë apo të shfuqizojë lejen përkatëse brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh.<br><br>3. Mosrespektimi i vendimit, si në paragrafin 2 të këtij neni, përbën shkak për inicim të procedurës penale dhe/apo për kundërvajtje ndaj personit përgjegjës.<br><br>**Neni 7**<br>**Organizimi i brendshëm i IQTK-së**<br><br>Organizimi i brendshëm i IQTK-së përcaktohet me akt nënligjor në pajtim me ligjin përkatës për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura. | protected areas of cultural heritage to ensure that the procedures according to the provisions of the laws in force for the protection of the cultural heritage have been respected.<br><br>2. If it is established that the permit, as in paragraph 1 of this article, was issued in violation of the legal provisions in force, the CICH shall issue a decision obligating the official of the competent body to suspend or revoke the respective permit within fifteen (15) days.<br><br>3. Failure to comply with the decision as in paragraph 2 of this article, constitutes grounds for initiating criminal and/or minor offence proceedings against the responsible person.<br><br>**Article 7**<br>**Internal organization of CICH**<br><br>The internal organization of the CICH shall be defined by means of a sub-legal act in accordance with the relevant law on the organization and functioning of state administration and independent agencies. | zaštićenih zona kulturnog nasleđa kako bi se osiguralo da se poštuju procedure u skladu sa odredbama važećih zakona o zaštiti kulturnog nasleđa.<br><br>2. Ukoliko se utvrdi da je dozvola, iz stava 1. ovog člana, izdata u suprotnosti sa važećim zakonskim odredbama, CIKN donosi rešenje kojim se obavezuje službeno lice nadležnog organa da suspenduje ili ukine odgovarajuću dozvolu u roku od petnaest (15) dana.<br><br>3. Nepostupanje po rešenju iz stava 2. ovog člana predstavlja osnov za pokretanje krivičnog postupka i/ili za prekršaje protiv odgovornog lica.<br><br>**Član 7**<br>**Unutrašnja organizacija CIKN-a**<br><br>Unutrašnja organizacija CIKN-a utvrđuje se podzakonskim aktom u skladu sa relevantnim zakonom o organizaciji i funkcionisanju državne administracije i nezavisnih agencija. |

| Neni 8<br>Udhëheqja e IQTK-së | Article 8<br>The management of CICH | Član 8<br>Rukovodstvo CIKN-a |
|---|---|---|
| 1. IQTK-ja udhëhiqet nga drejtori ekzekutiv, i cili gjithashtu është kryeinspektor i këtij inspektorati. | 1. CICH is led by the executive director, who is also the chief inspector of this inspectorate. | 1. CIKN vodi izvršni direktor, koji je i glavni inspektor ovog inspektorata. |
| 2. Kryeinspektori i IQTK raporton tek Ministri ne aspektin operacional, ndërsa tek Sekretari i Përgjithshëm ne aspektin administrativ. | 2. The Chief Inspector of CICH shall report to the Minister on operational matters and to the Secretary-General on administrative matters. | 2. Glavni inspektor CIKN-a odgovara ministru u operativnom aspektu, a generalnom sekretaru u administrativnom aspektu. |
| 3. Drejtori ekzekutiv i IQTK-së ka statusin e nëpunësit civil të nivelit të lartë drejtues sipas ligjit përkatës për zyrtarët publikë. | 3. The executive director of CICH holds the status of a civil servant of senior management level according to the relevant law on public officials. | 3. Izvršni direktor CIKN-a ima status civilnog službenika višeg upravnika prema relevantnom zakonu o javnim službenicima. |
| 4. Përzgjedhja dhe emërimi i drejtorit ekzekutiv të IQTK-së bëhet në pajtim me rregullat e përcaktuara për kategorinë e lartë drejtuese të nëpunësve civilë sipas legjislacionit përkatës për zyrtarët publikë. | 4. The selection and appointment of the CICH executive director shall be done in accordance with the rules defined for the senior management category of civil servants according to the relevant legislation on public officials. | 4. Izbor i imenovanje izvršnog direktora CIKN-a vrši se u skladu sa pravilima definisanim za kategoriju višeg upravnika civilnih službenika u skladu sa relevantnim zakonodavstvom za javne službenike. |
| 5. Nga hyrja në fuqi e këtij ligji, ministri ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për përzgjedhjen e drejtorit ekzekutiv të IQTK-së në pajtim me legjislacionin në fuqi. | 5. Upon entry into force of this law, the minister shall take all necessary actions for the selection of the CICH executive director in accordance with the legislation in force. | 5. Po stupanjem na snagu ovog zakona, ministar preduzima sve potrebne radnje za izbor izvršnog direktora CIKN-a u skladu sa važećim zakonima. |

| Neni 9<br>Funksionet e drejtorit ekzekutiv të IQTK-së | Article 9<br>Functions of the CICH executive director | Član 9<br>Funkcije izvršnog direktora CIKN-a |
|---|---|---|
| 1. Përveç funksioneve të përcaktuara në ligjin përkatës për organizmin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura dhe ligjin përkatës për inspektimet, drejtori ekzekutiv i IQTK-së ushtron edhe këto funksione: | 1. In addition to the functions specified in the relevant law on the organization and functioning of state administration and independent agencies and the relevant law on inspections, the executive director of the CICH shall also exercise the following functions: | 1. Izvršni direktor CIKN-a, pored funkcija definisanih relevantnim zakonom o organizaciji i funkcionisanju državne administracije i nezavisnih agencija i odgovarajućim zakonom o inspekcijskom nadzoru, obavlja i sledeće funkcije: |
| 1.1. përfaqëson IQTK-në në marrëdhënie me palët e treta dhe është përgjegjës për organizimin dhe koordinimin e funksionimit, si dhe për cilësinë dhe efektivitetin e veprimtarisë së tij; | 1.1. represents CICH in relations with third parties and is responsible for organizing and coordinating its functioning, as well as for the quality and effectiveness of its activity; | 1.1. zastupa CIKN u odnosima sa trećim licima i odgovoran je za organizaciju i koordinaciju funkcionisanja, kao i za kvalitet i efektivnost svoje aktivnosti; |
| 1.2. menaxhon burimet njerëzore të IQTK-së në pajtim me legjislacionin në fuqi; | 1.2. manages the human resources of CICH in accordance with the legislation in force; | 1.2.upravlja ljudskim resursima CIKN-a u skladu sa važećom zakonskom regulativom; |
| 1.3. propozon dhe menaxhon buxhetin e IQTK-së, në pajtim me legjislacionin në fuqi; | 1.3. proposes and manages the budget of CICH, in accordance with the legislation in force; | 1.3.predlaže i upravlja budžetom CIKN-a, u skladu važećom zakonskom regulativom; |
| 1.4. nxjerr vendime dhe udhëzime për veprimtarinë e strukturave administrative të IQTK-së në nivel qendror dhe për degët lokale përkatëse; | 1.4. issue decisions and directives for the activity of the CICH administrative structures at the central level and for the respective local branches; | 1.4. donosi odluke i uputstva za rad CIKN-ovih upravnih struktura na centralnom nivou i za odgovarajuće lokalne ogranke; |

| | | |
|---|---|---|
| 1.5. koordinon veprimtarinë e IQTK-së me organet qendrore dhe organet e tjera publike në fushën përkatëse të inspektimit; | 1.5. coordinates the activity of CICH with central bodies and other public bodies in the relevant field of inspection; | 1.5. koordinira rad CIKN-a sa centralnim organima i drugim javnim organima iz relevantne oblasti inspekcije; |
| 1.6. siguron zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë në fushën përkatëse të inspektimit; dhe | 1.6. ensures the implementation of legal and sub-legal acts that regulate the activity in the relevant field of inspection; and | 1.6. obezbeđuje sprovođenje zakonskih i podzakonskih akata kojima se uređuje delatnost u odgovarajućoj oblasti inspekcijskog nadzora; i |
| 1.7. kryen funksione të tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. | 1.7. performs other functions defined by the legislation in force. | 1.7. obavlja i druge funkcije utvrđene važećim zakonskim regulativom. |
| **Neni 10**<br>**Financimi i Inspektoratit Qendror të Trashëgimisë Kulturore** | **Article 10**<br>**Funding of the Central Inspectorate of Cultural Heritage** | **Član 10**<br>**Finansiranje Centralnog inspektorata o kulturnom nasleđu** |
| 1. Mjetet për financimin e punës së Inspektoratit sigurohen nga buxheti i Republikës së Kosovës, të hyrat vetanake, donacionet dhe financimet e tjera alternative në përputhje me legjislacionin në fuqi. | 1. The means for financing the work of the Inspectorate are provided by the budget of the Republic of Kosovo, own revenues, donations and other alternative financing in accordance with the legislation in force. | 1.Sredstva za finansiranje rada Inspektorata obezbeđuju se iz budžeta Republike Kosovo, sopstvenih prihoda, donacija i drugog alternativnog finansiranja u skladu sa zakonima na snazi. |
| 2. Inspektorati ka kod të veçantë buxhetor dhe i menaxhon financat e saj. | 2. The inspectorate has a distinct budget code and manages its finances. | 2. Inspektorat ima poseban budžetni kod i upravlja svojim finansijama. |

| Neni 11<br>**Mbikëqyrja e IQTK-së** | Article 11<br>**Supervision of CICH** | Član 11<br>**Nadzor CINK-a** |
|---|---|---|
| 1. Ministria mbikëqyr performancën e IQTK-së në pajtim me ligjin përkatës për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe të agjencive të pavarura. | 1. The Ministry shall supervise the performance of the CICH in accordance with the relevant law on the organization and functioning of state administration and independent agencies. | 1. Ministarstvo vrši nadzor nad radom CNK u skladu sa relevantnim zakonom o organizaciji i funkcionisanju državne administracije i nezavisnih agencija. |
| 2. Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm mbështet Ministrinë për mbikëqyrjen e performancës së IQTK-së. | 2. The Office of the Inspector General shall support the Ministry in supervising the performance of the CICH. | 2. Kancelarija generalnog inspektora podržava Ministarstvo u nadgledanju rada CIKN-a. |
| **Neni 12**<br>**Ankesat** | **Article 12**<br>**Appeals** | **Član 12**<br>**Žalbe** |
| 1. Shqyrtimi i ankesave bëhet në pajtim me ligjin përkatës për procedurën e përgjithshme administrative. | 1. The review of appeals shall be conducted in accordance with the relevant law on general administrative procedure. | 1. Žalbe se razmatraju u skladu sa relevantnim zakonom o opštem administrativnoj proceduri. |
| 2. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, për masat urgjente, ankesat e veçanta shqyrtohen në pajtim me ligjin përkatës për inspektimet. | 2. Notwithstanding paragraph 1 of this Article, special appeals for urgent measures shall be reviewed in accordance with the relevant law on inspections. | 2. Osim stava 1. ovog člana, za hitne mere, posebne pritužbe razmatraju se u skladu sa odgovarajućim zakonom o inspekcijskom nadzoru. |
| **Neni 13**<br>**Dispozita kalimtare** | **Article 13**<br>**Transitional provisions** | **Član 13**<br>**Prelazne odredbe** |
| Deri në hyrjen në fuqi të akteve nënligjore që burojnë nga ky ligj zbatohet Rregullorja për Kompetencat, | Until the entry into force of the sub-legal acts deriving from this law, the Regulation on Competences, Authorizations and | Do stupanja na snagu podzakonskih akata koji proizilaze iz ovog zakona, primenjivaće se Uredba o nadležnostima, |

| | | |
|---|---|---|
| Autorizimet dhe Procedurat e Inspektimit dhe Ankesave të Inspektoratit të Trashëgimisë Kulturore, me kusht që dispozitat e kësaj rregulloreje të mos bien në kundërshtim me këtë ligj. | Inspection and Appeals Procedures of the Cultural Heritage Inspectorate shall apply, provided that the provisions of this regulation are not in conflict with this law. | ovlašćenjima i inspekcijskom i žalbenom postupku Inspektorata za kulturno nasleđe, pod uslovom da odredbe ove uredbe nisu u suprotnosti sa ovim zakonom. |
| **Neni 14**<br>**Hyrja në fuqi** | **Article 14**<br>**Entry into force** | **Član 14**<br>**Stupanje na snagu** |
| Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës. | This law shall enter into force fifteen (15) days following its publication in the Official Gazette of the Republic of Kosovo. | Ovaj zakon stupa na snagu petnaest (15) dana od dana objavljivanja u Službenom listu Republike Kosovo. |
| Albulena Haxhiu | Albulena Haxhiu | Albulena Haxhiu |
| Kryetare e Kuvendit të Republikës të Kosovës | Chairwoman of the Assembly of the Republic of Kosovo | Predsednica Skupštine Republike Kosova |